



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 91

Tiranë – E premte, 28 prill 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut ankimi nr. 74941/14, datë 24.1.2017	Kleopatra Caka kundër Shqipërisë..... 5201
Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut ankimi nr. 23136/13, datë 24.1.2017	Selvie Rushiti kundër Shqipërisë..... 5201
Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut ankimi nr. 53103/15, datë 24.1.2017	Shkelqim Hatija kundër Shqipërisë..... 5203



GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE  
TË NJERIUT

SEKSIONI I PARË

VENDIM

Ankimi nr. 74941/14

Kleopatra CAKA  
kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Parë) e mbledhur më 24 janar 2017, si një Komitet i përbërë nga:

Kristina Pardalos, Kryetare

Pauliine Koskelo,

Tim Eicke, gjykatës,

dhe Renata Degener, Zëvendës Regjistrare e Seksionit,

Në lidhje me ankimin e mësipërm të paraqitur më 18 nëntor 2014,

Në lidhje me deklaratat formale, të cilat pranonin një zgjidhje miqësore të çështjes,

Pasi ka diskutuar, vendos si më poshtë vijon:

FAKTE DHE PROCEDURA

Ankuesja, zj. Kleopatra Caka, është një shtetase shqiptare, e cila ka lindur në vitin 1963 dhe jeton në Tiranë. Ajo u përfaqësua përpara Gjykatës nga z. F. Caka, avokat i cili ushtron profesionin në Tiranë.

Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjentja e saj, zj. A. Hicka nga Avokatura e Shtetit.

Ankuesja ankohej se kishte pasur një shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës, për moszbatimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës, dhënë në favorin e saj, në të cilin urdhërohej pagesa e dëmeve si rezultat i pushimit të saj të padrejtë nga puna.

Më 22 shtator dhe 3 nëntor 2016, Gjykata mori deklaratat për zgjidhje miqësore të firmosura nga palët, sipas së cilave ankuesja ishte dakord të hiqte dorë nga kërkesa të tjera kundër Shqipërisë në lidhje me faktet që çuan në këtë ankim kundër Shqipërisë kundër një mase të marrë nga Qeveria për t’i paguar asaj EUR 10,400 (dhjetë mijë e katërqind euro) për të mbuluar çdo dëm monetar dhe jomonetar si edhe kostot dhe shpenzimet, të cilat do të konvertohen në vlerën monetare vendase në normën e zbatueshme në datën e pagesës, dhe nuk do të preken nga asnjë taksë e

cila mund të jetë e zbatueshme. Kjo shumë do të paguhet brenda tre muajve nga data kur njoftohet vendimi i marrë nga Gjykata. Në rast se shumica e mësipërme nuk paguhet brenda një periudhe tre-mujore, Qeveria merr përsipër që të paguajë një interes të thjeshtë për të, që nga momenti kur kjo periudhë përfundon deri në shlyerjen e saj, në një normë të barabartë me normën marginale të huasë të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit plus pikë tre përqindëshe. Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

LIGJI

Gjykata merr parasysht marrëveshjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo është siguruar se marrëveshja bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut siç përcaktohet në Konventë dhe në Protokollet e saj, dhe nuk gjen asnjë arsye për të justifikuar një shqyrtim të vazhduar të ankimit. Bazuar në sa më sipër, është me vend që çështja të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë anonime, *Vendos* ta përjashtojë ankimin nga lista e saj e çështjeve bazuar në nenin 39 të Konventës.

E hartuar në anglisht dhe e njoftuar me shkrim më 16 shkurt 2017.

Renata Degener  
Zëvendës Regjistrare

Kristina Pardalos  
Kryetare

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE  
TË NJERIUT

SEKSIONI I PARË

VENDIM

Ankimi nr. 23136/13

Selvie RUSHITI  
kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Parë) e mbledhur më 24 janar 2017, si një Komitet i përbërë nga:

Linos-Alexandre Sicilianos, Kryetar

Aleš Pejchal,

Armen Harutyunyan, gjykatës,

dhe Renata Degener, Zëvendës Regjistrare e Seksionit,

Në lidhje me ankimin e mësipërm të paraqitur më 1 prill 2013,



Në lidhje me deklaratën e dorëzuar nga Qeveria e paditur më 16 shtator 2015 dhe parashtrimet e tyre të datës 4 korrik 2016, në të cilat i kërkohet Gjykatës në mënyrë të prerë që të përjashtojë ankimin nga lista e çështjeve dhe duke marrë në konsideratë që ankuesi nuk dorëzoi asnjë koment si përgjigje,

Pasi ka diskutuar, vendos si më poshtë vijon:

#### FAKTE DHE PROCEDURA

Ankuesja, zj. Selvie Rushiti, është një shtetase shqiptare, e cila ka lindur në vitin 1958 dhe jeton në Tiranë.

Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjentja e saj, zj. A.Hicka, nga Avokatura e Shtetit.

Ankuesja shprehu shqetësimin për kohëzgjatjen e tepruar të procedurave civile, të cilat filluan më 27 shkurt 2001 dhe përfunduan më 12 mars 2013.

#### LIGJI

Ankuesja shprehu shqetësimin për kohëzgjatjen e procedurave. Ajo i referua nenit 6 § 1 të Konventës.

Më 16 shtator 2015, Gjykata mori një deklaratë për një marrëveshje miqësore të firmosur nga Qeveria, sipas së cilës Qeveria e Shqipërisë ofronte që t’i paguante ankueses EUR 1,800 (një mijë e tetëqind euro) për të mbuluar çdo dhe të gjithë dëmin jomonetar si edhe kostot dhe shpenzimet, të cilat do të konvertohen në vlerën monetare vendase në normën e zbatueshme në datën e pagesës, duke mos u ndikuar nga asnjë taksë që mund të jetë e zbatueshme. Kjo shumë do të jetë e pagueshme brenda tre muajve nga data kur njoftohet vendimi i marrë nga Gjykata. Në rast se Gjykata nuk e paguan këtë shumë brenda periudhës së sipërpërmendur tre-mujore, Qeveria ndërmerret të paguajë interes për të, që nga momenti i përfundimit të periudhës deri në shlyerje, në një normë të barabartë me normën marginale të huasë të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagesës plus pikë tre përqindëshe. Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kjo deklaratë u dorëzua si përgjigje ndaj propozimit të Zyrës së Regjistrimit për një marrëveshje për zgjidhje miqësore, adresuar të dyja palëve.

Faqe | 5202

Ankuesja nuk iu përgjigj propozimit të Zyrës së Regjistrimit.

Më 4 korrik 2016, Qeveria informoi Gjykatën se deklarata e tyre e firmosur, e datës 16 shtator 2015, duhet të trajtohet si një deklaratë njëpalëshe me synimin për të zgjidhur çështjen e ngritur nga ankimi. Gjithashtu, ajo theksoi si më poshtë vijon:

“Qeveria shqiptare e pranon se ka pasur një shkelje të të drejtave të ankueses, të garantuara nga neni 6 § 1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si rezultat i tejzgjatjes së jashtëzakonshme të procedurave gjyqësore. Për sa më sipër, Qeveria ofron të paguajë *ex gratia* 1,800 euro në favor të Zj. Selvie Rushiti”.

Ankuesja nuk parashtrroi asnjë koment.

Gjykata vëren se pavarësisht faktit se Qeveria nuk parashtrroi një formë të re, të veçantë të deklaratës së njëanëshme, ajo vazhdon të ruajë qartazi qëndrimin e saj se deklarata e firmosur për zgjidhje miqësore e dorëzuar si përgjigje ndaj propozimit të Regjistrimit, duhet të trajtohet si një deklaratë e njëanëshme. Në përputhje me rrethanat, Gjykata do të marrë parasysh faktin se Qeveria dorëzoi një deklaratë të njëanëshme me qëllimin për të zgjidhur çështjen e ngritur nga ankimi.

Gjykata përsërit se neni 37 i Konventës parashikon se në çdo fazë të procedurave, ajo mund të vendos të përjashtojë një ankim nga lista e saj e çështjeve në rastin kur rrethanat çojnë në një nga përfundimet e përcaktuara sipas pikës (a), (b) ose (c) të paragrafit të parë të atij neni. Neni 37 § 1 (c) i mundëson Gjykatës që veçanërisht ta përjashtojë një çështje nga lista e saj nëse: “për cilëndo arsye tjetër të dhënë nga Gjykata, nuk ka më justifikim për vazhdimin e shqyrtimit të ankimit.”

Gjithashtu, ajo thekson se në rrethana të caktuara, ajo mund të përjashtojë një ankim sipas nenit 37 § 1 (c) bazuar në një deklaratë njëpalëshe nga Qeveria e paditur, edhe nëse ankuesi dëshiron që të vijojë shqyrtimi i çështjes.

Për këtë qëllim, Gjykata ka shqyrtuar deklaratën bazuar në parimet të cilat dalin nga praktika e saj gjyqësore, veçanërisht vendimi Tahsin Acar (Tahsin Acar kundër Turqisë) kundërshtime paraprake [GJP], nr. 26307/95, §§ 75-77, GJEDNJ 2003-VI; WAZA Sp. z.o.o kundër Polonisë (vend.), nr. 11602/02, 26 Qershor 2007; dhe Sulwińska kundër Polonisë (vend.), nr. 28953/03, 18 Shtator 2007).



Gjykata ka shqyrtuar në një sërë çështjesh, duke përfshirë edhe ato të sjella kundër Shqipërisë, praktikën e saj në lidhje me ankesat për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për kohëzgjatjen e procedurave (shiko Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë, (nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129.12 dhe 31355/09, §§ 63-64, 1 prill 2014.)

Gjykata vëren se në parashtrimet e saj të datës 4 korrik 2016, Qeveria njihje shkeljen e nenit 6 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave. Më tej, Gjykata vëren se shumica e parave e ofruar synon të kompensojë ankuesen për dëmin e vuajtur si rezultat i kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore.

Duke pasur parasysh natyrën e parashtrimeve të bëra nga Qeveria, si edhe shumën e propozuar për kompensim – e cila është në përputhje me shumatat e dhëna në raste të ngjashme – Gjykata mendon se nuk është më e justifikueshme të vazhdohet me shqyrtimin e ankimit (neni 37 § 1 (c)).

Për më tepër, sipas arsyeve të mësipërme, dhe veçanërisht duke pasur parasysh praktikën e qartë dhe të gjerë gjyqësore, mbi këtë tematikë, se duke respektuar të drejtat e njeriut sipas përcaktimeve në Konventë dhe në Protokollin përkatës, nuk kërkohet që të vazhdohet shqyrtimi i ankimit (neni 37 § 1 *in fine*).

Gjykata vendos që kjo shumë duhet të konvertohet në vlerën monetare kombëtare në normën e zbatueshme në datën e pagesës, dhe duhet të paguhet brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës të lëshuar në përputhje me nenin 37 § 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në rast se nuk realizohet pagesa brenda kësaj periudhe një interes i thjeshtë paguhet për shumën konkrete në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane plus pikë tre përqind.

Përfundimisht, Gjykata thekson se nëse Qeveria nuk respekton kushtet e deklaratës së saj të njëanshme, ankimi do të rikthehet në listë në përputhje me nenin 37 § 2 të Konventës (Josipović kundër Serbisë (vend.), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Për sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime, Merr parasysh kushtet e deklaratës së Qeverisë së paditur sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe modalitetet për të garantuar përputhshmërinë me masat e referuara në të;

Vendos ta përjashtojë ankimin nga lista e çështjeve në përputhje me nenin 37 § 1 të Konventës.

E hartuar në anglisht dhe e njoftuar me shkrim më 16 shkurt 2017.

Renata Degener                      Linos-Alexandre Sicilianos  
Zëvendës Regjistrare                      Kryetar

## GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

### SEKSIONI I PARË

#### VENDIM

Ankimi nr. 53103/15  
Shkelqim HATIJA  
kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Parë) e mbledhur më 24 janar 2017, si një Komitet i përbërë nga:

Linos-Alexandre Sicilianos, Kryetar  
Aleš Pejchal,

Armen Harutunuan, gjykatës,

dhe Renata Degener, Zëvendës Regjistrare e Seksionit,

Në lidhje me ankimin e mësipërm të paraqitur më 21 tetor 2015,

Në lidhje me deklaratat e paraqitura nga Qeveria e paditur më 19 shtator 2016 dhe parashtrimet e saj më 11 tetor 2016, ku i kërkon qartazi Gjykatës të përjashtonte ankimin nga lista e çështjeve dhe përgjigjen e ankuesit ndaj kësaj deklaratë,

Pasi ka diskutuar, vendos si më poshtë vijon:

#### FAKTET DHE PROCEDURAT

Ankuesi, Z. Shkelqim Hatija, është një shtetas shqiptar, i cili ka lindur në vitin 1966 dhe jeton në Fier.

Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga agentja e saj Zj. A. Hicka nga Avokatura e Shtetit.

Ankuesi shfaq pakënaqësinë për tejzgjatjen e procedurave civile, veçanërisht të atyre përpara Gjykatës së Lartë.



## LIGJI

Ankuesi shprehu pakënaqësinë në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave. Ai u mbështet në nenin 6 §1 të Konventës.

Më 19 shtator 2016, Gjykata mori një deklaratë për zgjidhje miqësore të firmosur nga Qeveria, sipas së cilës Qeveria e Shqipërisë ofronte t'i paguante ankuesit 1,000 euro (një mijë euro) për të mbuluar çdo dhe të gjitha dëmet jo monetare si edhe kostot dhe shpenzimet, të cilat do të konvertoheshin në monedhën kombëtare në normën e zbatueshme në datën e pagesës, dhe nuk do të ngarkohej me asnjë taksë, e cila mund të ishte e zbatueshme. Kjo shumë do të jetë e pagueshme brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata. Në rast se kjo shumë nuk paguhet brenda periudhës tre-mujore, Qeveria ndërmerret të paguajë interesin e thjeshtë mbi të, që prej përfundimit të asaj periudhe deri në shlyerje, në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së vonesës plus pikë tre përqind. PAGESA DO TË PËRBËJË ZGJIDHJEN PËRFUNDIMTARE TË ÇËSHTJES. Kjo deklaratë u dorëzua si përgjigje ndaj propozimit të Zyrës së Regjistrimit për një marrëveshje për zgjidhje miqësore, adresuar tek të dy palët.

Ankuesi nuk e pranoi propozimin për zgjidhje miqësore.

Më 11 tetor 2016, Qeveria informoi Gjykatën se nëse ankuesi refuzonte të pranonte propozimin për zgjidhje miqësore, deklarata e saj e firmosur, e datës 19 Shtator 2016 duhej të trajtohej si një deklaratë e njëanshme e paraqitur me synimin për të zgjidhur çështjen e ngritur nga ankimi.

Me anën e një letre të dërguar më 24 tetor 2016, ankuesi tregonte se nuk ishte i kënaqur me kushtet e deklaratës, sepse dëmi monetar dhe jo monetar që kishte mbuluar ishte më i madh sesa shumën e ofruar nga Qeveria.

Gjykata vëren se pavarësisht faktit se Qeveria nuk paraqiti një formë të re, të mëveçantë për deklaratën e njëanshme, ajo mbrojti qartazi pozicionin e saj se deklarata e saj e firmosur për zgjidhje miqësore e dorëzuar si përgjigje ndaj propozimit të Zyrës së Regjistrimit, duhej të trajtohej si një deklaratë e njëanshme. Për këtë arsye, Gjykata gjykon se Qeveria dorëzoi një deklaratë të njëanshme me synimin për të zgjidhur çështjen e ngritur nga ankimi.

Gjykata thekson se neni 37 i Konventës parashikon se në cilëndo fazë të procedimeve, ajo mund të vendosë të nxjerrë një ankesë nga lista e saj e çështjeve, në rastin kur rrethanat çojnë në një nga konkluzionet e specifikuar në pikën (a), (b) ose (c) të paragrafit 1 të atij neni. Neni 37 § 1 (c) i jep të drejtën Gjykatës që të përjashtojë një çështje nga lista e saj veçanërisht nëse: “për cilëndo arsye tjetër të përcaktuar nga Gjykata, shqyrtimi i ankimit nuk është më i justifikueshëm që të vazhdohet”.

Gjithashtu, ajo thekson se në rrethana të caktuara, ajo mund të përjashtojë një ankim sipas nenit 37 § 1 (c) bazuar në një deklaratë të njëanshme nga Qeveria e paditur edhe nëse ankuesi dëshiron që të vazhdojë shqyrtimi i çështjes.

Për këtë qëllim, Gjykata e ka shqyrtuar deklaratën bazuar në parimet që dalin nga kjo praktikë gjyqësore, veçanërisht Vendimi Tahsin Acar (Tahsin Acar kundër Turqisë (kundërshtimet paraprake) [GJP], nr. 26307/95, §§ 75-77, GJEDNJ 2003-VI; WAZA Sp. Z o.o kundër Polonisë (vendim), nr. 11602/02, 26 qershor 2007; dhe Sulwińska kundër Polonisë (vendim), nr. 28953/03, 18 shtator 2007).

Gjykata, në një sërë çështjesh, duke përfshirë ato të sjella kundër Shqipërisë, e ka krijuar praktikën e saj në lidhje me ankesat për shkeljen e Nenit 6 § 1 të Konventës që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procedimeve (shiko Luli dhe të Tjerët kundër Shqipërisë, nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09, §§ 63-64, 1 prill 2014).

Gjykata vëren se shumën e parave e ofruar nga Qeveria synon të kompensojë ankuesin për dëmin e vuajtur si rezultat i kohëzgjatjes së procedimeve gjyqësore.

Duke pasur parasysh natyrën e parashtrimeve të bëra nga Qeveria, si edhe shumën e kompensimit të propozuar – e cila është në përputhje me shumën e akorduar në çështje të ngjashme – Gjykata gjykon se nuk është më e justifikueshme që të vazhdohet shqyrtimi i ankimit (neni 37 § 1 (c)).

Për më tepër, bazuar në arsyet e mësipërme dhe veçanërisht duke pasur parasysh praktikën ligjore të qartë dhe të gjerë mbi tematikën, Gjykata konstaton se në respektim të të drejtave të njeriut siç përcaktohet në Konventë dhe në Protokollet e saj nuk kërkohet që të vazhdohet shqyrtimi i ankimit (neni 37 § 1 *in fine*).



Gjykata gjykon se kjo shumë duhet të konvertohet në vlerën monetare vendase në normën e zbatueshme në ditën e pagesës dhe të paguhet brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës të lëshuar në përputhje me nenin 37 § 1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në rast se pagesa nuk realizohet brenda kësaj periudhe, interesi i thjeshtë duhet të paguhet për shumën në fjalë në normën e barabartë me normën marginale të huadhënies të Bankës Europiane Qendrore plus pikë tre përqind.

Përfundimisht, Gjykata thekson se nëse Qeveria nuk respekton kushtet në deklaratën e tyre të njëanëshme, ankimi mund të rikthehet në listë në përputhje me nenin 37 § 2 të Konventës (Josipović kundër Serbisë (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Bazuar në sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime, *Merr parasysb* kushtet e deklaratës së Qeverisë së paditur sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe modalitetet për të garantuar respektim të premtimeve të referuara në të;

Vendos ta përjashtojë ankimin nga lista e çështjeve në përputhje me nenin 37 §1 (c) të Konventës.

E hartuar në anglisht dhe e njoftuar me shkrim më 16 Shkurt 2017.

Renata Degener  
Zëvendës Regjistrare

Linus-Alexandre Siciliano  
Presidente

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 56 lekë